



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Datë 02/10/2020

Konsultimi prioritetive për Thirrjen e Tretë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile

Bashkia Librazhd në bashkëpunim me Programin Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) ka filluar procesin e shpalljes së Thirrjes e Tretë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të). Hapi i parë i këtij procesi është konsultimi me OSHC-të i prioritetive të thirrjes. Duke patur parasysh situatën në vend ku takimet me pjesëmarrje të lartë individësh nuk janë të lejuara, bashkia ka vendosur të kryej procesin e konsultimit të prioritetive online.

Në këtë kuadër bashkia Librazhd bazuar në dokumentat strategjike ka përzgjedhur pesë prioritate të detajuar secili me dy nënprioritete si më poshtë.

1. Shërbime komunitare për grupet e marginalizuara

- 1.1. Shërbime komunitare për moshën e tretë dhe personat me aftësi të kufizuara.
- 1.2. Shërbime komunitare për komunitetin Rom dhe Egjyptian

2. Zhvillimi i Turizmit

- 2.1. Përdorimi i mjeteve inovatore në promovimin e vlerave turistike dhe kulturore të zonës.
- 2.2. Organizimi i aktiviteteve që synojnë promovimin e burimeve turistike të Bashkisë Librazhd.

3. Zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit

- 3.1. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në natyrë.
- 3.2. Ndërgjegjësim mbi mbrojtjen e mjedisit duke e konsideruar atë në disa dimensionet: peisazhit natyror, historik, kulturor, social, biodiversitetit etj.

4. Mbështetja e fermerëve

- 4.1. Evidentimi i produkteve bujqësore vendase, ndërgjegjësimi mbi benefitet e regjistrimit të markave dhe promovimi në treg.
- 4.2. Rritja e kapaciteteve të fermerëve lokal

5. Mbështetje për zhvillimin ekonomik

- 5.1. Mbështetje ose krijimi i Start-up, me prioritet të rinjtë dhe gratë.
- 5.2. Programe mbështetëse për agrobizneset



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Bashkia Librazhd fton të gjitha OSHC-të e interesuara të marrin pjesë në procesin e konsultimit të këtyre prioritetëve. Thirrja e trete publike për OSHC-të do të ketë tre prioritete, secila e detajuar me dy nën prioritete. OSHC-të marrin pjesë në procesin e konsultimit duke:

1. Dërguar komentet e tyre mbi prioritetet me email brenda datës 08/10/2020
Email: info@bashkialibrazhd.gov.al
2. Votuar në anketën për zgjedhjen e tre nga pesë prioritetet e propozuara brenda datës 08/10/2020.
Link për anketën: <https://www.surveymonkey.com/r/5TVR92F>
3. Marë pjesë në takimin online në datë 07/10/2020 ora 13:00
Link: <https://undp.zoom.us/j/81571793653?pwd=VGhaNTZpOU14Q24wUFITRHUwN084UT09>
ID e takimit: 815 7179 3653
Passcode: 933592

Për të përcaktuar proritetet finale të thirrjes së tretë publike, bashkia Librazhd do të shqyrtoj të gjitha komentet dhe propozimet e shoqërisë civile sipas afateve më poshte:

Fazat e procesit të konsultimit të prioritetëve	Mekanizmat për përfshirjen e OSHC-ve në proces.	Kohëzgjatja
1. Përzgjedhja e 5 prioritetëve të propozuara nga bashkia dhe publikimi i tyre ne faqen e bashkisë. Njoftimi do të ketë një adresë emaili ku mund të dërgohen komente mbi përzgjedhjen e 3 prioritetëve secili me dy nën prioritete.	Publikimi në faqen e bashkisë dhe rrjetet sociale të bashkisë dhe dërgohet me email listës së OSHC-ve.	Afati për komente 5 ditë pune.
2. Organizimi i një “monkey survey” për të votuar 3 nga 5 prioritetet.	Publikimi në faqen e bashkisë dhe rrjetet sociale dhe gjithashtu ju dërgohet me email listës së OSHC-ve.	Afati për votim 5 ditë pune.
3. Organizimi i një takimi online në platforma si Zoom/Skype ku të kenë akses për të marë pjesë të gjithë organizatat e interesuara.	Publikimi i njoftimit në faqen e bashkisë dhe rrjetet sociale dhe për takimin njoftohen me email të gjitha OSHC-të sipas listës disponibël në bashki.	Takimi online 4 ditë pune pas njoftimit.
4. Shqyrtimi i të gjitha të dhënave të mbledhura nga Bashkia (minuta takimi online, komente dhe votimit).	Hartimi i një raporti nga grupi i punës që merr në shqyrtim materialet. Ky grup mund të përfshijë edhe pjesëmarrës nga ReLOaD.	Brenda 8 ditë pune pas shpalljes së prioritetëve të propozura nga Bashkia.
5. Shpallja dhe publikimi ne faqen e bashkisë dhe rrjetet sociale i thirrjes së plotë publike me 3 prioritetet e përzgjedhura.	Publikimi në faqen e bashkisë i paktës së plotë të thirrjes së plotë publike me 3 prioritetëve të përzgjedhura.	10 ditë pune nga data e shpalljes në faqe duhet të publikohen



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



		prioritetet finale.
--	--	---------------------